



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

I Nr. 292 Dt. 29/06/2012  
PRISHTINË A

**Për: Enver Halimi,**  
**Kryesues i Bordit të Zyrës**  
**së Rregullatorit për**  
**Energji**  
**Rr. "Hamdi Mramori" nr.1**  
**Prishtinë**

**Arben Gjukaj**  
**Drejtor Menaxhues KEK SH.A**

**Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.**  
**Bulevardi Bill Clinton nr.3**  
**Prishtinë 10000,**  
**Republika e Kosovës**  
[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

**Datë: 29.06.2012**

**Tema: Komentet e KEK-ut lidhur me Raportin e Parë Konsultativ të Rishikimit të Shtatë Tarifor të Energjisë Elektrike**

I nderuari Z. Halimi,

Kjo letër përmbledh përgjigjen e KEK-ut ndaj Raportit të Parë Konsultativ (RK) të Rishikimit të Shtatë (Shumëvjeçar) të Tarifave të Energjisë Elektrike (ETR7), të lëshuar më 11 qershor 2012. Komentet e përmbledhura dhe çështjet kryesore janë përfshirë në këtë letër. Komentet e detajuara janë shënuar në vetë Raportin Konsultativ dhe në tabelën e cila i adreson 47 draft fletë pune të propozuara nga ana e ZRRE-së si të dhëna për një model që është duke u zhvilluar.

Ekzistojnë koncepte dhe informacione të reja të shumëfishta të cilat duhet të paraqiten në Raportin Konsultativ, prandaj KEK-u do të dëshironte që t'i adresonte çështjet kryesore, si kontabiliteti rregullativ, raportimi rregullativ dhe matja e performancës, të cilat po paraqiten në këtë raport, përveç vetë procesit tarifor.

### Historiku

Më 15 qershor 2012, unë ju kam shkruar për të shprehur shqetësimin rreth procesit kryesor që po propozohet nga ZRRE-ja ku të licencuarit nuk kërkojnë më që të zhvillojnë propozimet tarifore për rishikim dhe aprovim nga ZRRE-ja. KEK-u ka supozuar se Rregullat për Caktimin e Çmimeve ishin bazuar në konceptin e dorëzimit të Licencuarit dhe rishikimin e ZRRE-së, mirëpo në përgjigjen tuaj të datës 22 qershor ju e keni bërë të qartë se roli i të Licencuarit është ofrimi i të dhënave historike dhe të parashikuara, të cilat ZRRE do t'i përdorë për zhvillimin e të Hyrave të Lejuara për tarifa me pakicë dhe pastaj për të Hyrat e Lejuara për çdo të Licencuar.

*"Deklarata që "Rregullat për Caktimin e Çmimeve e bëjnë të qartë se çdo i licencuar duhet të dorëzojë në ZRRE propozimin tarifor" nuk ka bazë ligjore, meqenëse Rregullat për Caktimin e Çmimeve nuk parashohin në asnjë mënyrë që ZRRE-ja të vlerësojë propozimin tarifor nga KEK-u, mirëpo që ZRRE-ja rishikon të hyrat maksimale të lejuara (HML) për të gjithë të licencuarit përveç Furnizuesit Publik."*

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e korporatizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës  
Numri i Regjistrimit: 70325399

Zyra e regjistruar: Rr. Nënë Tereza Nr. 36, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

Meqenëse ju keni vendosur që roli i të Licencuarit në procesin tarifor është thjesht të plotësojë të dhënat në formular, në mënyrë që ZRRE-ja t'i përpunojë ato në një model të vetin, përgjigja e KEK-ut do të fokusohet fillimisht në të dhënat që po kërkohen.

Duket se ka një perceptim se KEK-u nuk është i gatshëm që t'i ofrojë informacione ZRRE-së. Si Drejtor Menaxhues, unë dëshiroj që ta bëj të plotësisht të qartë se ZRRE-ja ka qasje në të gjitha informatat e kontabilitetit, informatat operative dhe teknike që KEK-u ka (duke iu nënshtruar çështjeve konfidenciale të cilat KEK-u dhe ZRRE-ja i kanë realizuar me sukses në të kaluarën). Natyrisht, KEK-u mund të ofrojë vetëm informatat që i ka, prandaj KEK-u është i gatshëm që të punojë me ZRRE-në që të përshtatë nevojat për të dhëna që tani e tutje, ashtu siç është diskutuar në këtë letër.

### **Rëndësia e Përfshirjes së Investitorit të Ri të KKDFE**

Edhe pse KEK-u do t'i japë komentet e tij në lidhje me informatat që po kërkohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesi Publik, ne nuk mund të angazhohim investitorin e ri të KKDFE-së për sisteme specifike të kontabilitetit dhe raportimit. KEK-u sugjeron që kjo do të ishte një kohë ideale për ZRRE-në që të përfshijë edhe investitorin e KKDFE-së në proceset e reja dhe në nevojat për informata, meqë ata do t'i formulojnë sistemet e tyre të menaxhimit. Kjo do të ishte një mënyrë efektive për të siguruar se të dhënat e nevojshme për ZRRE-në janë në dispozicion sa më shpejt që të jetë e mundur, meqë investitori i ri mund të fillojë sigurimin e tyre në nivelin që nevojitet.

### **Nevoja për një Plan Kontabël Rregullativ**

Siç u diskutua në Raportin Konsultativ, ZRRE-së i duhen informacione specifike për koston, në mënyrë që të kryejë misionin e saj të rregullatorit. Kjo është e përbashkët për të gjitha organet rregullative dhe në përgjithësi lehtësohet nga një plan kontabël rregullativ. KEK-u ka një plan kontabël i cili fillimisht është i fokusuar në plotësimin e nevojave të kontabilitetit dhe raportimit (në përputhshmëri me SNFR) dhe menaxhimin e nevojave për informacione. Kontabiliteti rregullativ shton edhe një dimension tjetër në nevojat informative. Në RK nuk është përmendur plani kontabël rregullativ, megjithatë në mënyrë që të ofrohen informacione kontabël në nivelin e detajuar në shumë formularë të të dhënave, shihet qartë se ZRRE ka nevojë për zhvillimin e një Plani Kontabël Rregullativ nëse i duhen informacione të një niveli të detajuar specifik. ZRRE inkurajohet që të punojë së bashku me Kontabilitetin e KEK-ut për të rishikuar planin kontabël aktual të KEK-ut dhe ta përdorë atë si pikë fillestare. Disa prej informacioneve që po kërkohen mund të sigurohen nëse KEK-u modifikon planin e tij kontabël që hyn në fuqi me vitin financiar 2013.

Disa prej informacioneve të tjera janë shumë më komplekse dhe do të kërkonin zhvillimin e sistemeve të reja për sigurimin e informacioneve në nivele shumë të ulëta. Kjo nuk do të ishte në dispozicion deri pas vitit 2013 dhe kërkon përpjekje dhe kosto të konsiderueshme për zhvillimin e sistemit. KEK-u është i gatshëm të punojë me ZRRE-në që të përcaktojë mënyrën më efektive për plotësimin e nevojave për zhvillim tarifor.

KEK-u ka implementuar së fundi një Modul të ri për Asetet Fikse. Ai është përdorur për të ofruar të dhëna për asetet fikse që kanë të bëjnë me bartjen e kufirit midis KEK/KOSTT. ZRRE dukej e kënaqur me nivelin e të dhënave të ofruara, dhe KEK-u rekomandon që ky modul të përdoret si bazë për raportimin e aseteve fikse.

Është e qartë se të dhënat e vitit të kaluar mund të ofrohen vetëm në nivelin që ishte zënë fillimisht. Për vitet para vitit 2013, KEK-u është i gatshëm të ofrojë çdo informatë nga baza e tij e të dhënave kontabël, megjithatë ato mund të mos jenë në dispozicion në nivele më të vogla të detajeve.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e korporatizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës

Numri i Regjistrimit: 70325399

Zyra e regjistruar: Rr. Nënë Tereza Nr. 36, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës

## **Standardizimi i Raportimit të Rregullatorit për Informacione Teknike dhe Operative**

Ngjashëm me informacionet kontabël të diskutuara më sipër, një rishikim i të dhënave të propozuara tregon se po kërkohen të dhëna të ndryshme teknike dhe operative. Disa prej atyre të dhënave janë në dispozicion dhe të dhënat e tjera do të duhet të definohen, si dhe metodat e zhvilluara për sigurimin e informacioneve.

Disa informata që kanë të bëjnë me të dhënat mbi koston me të dhënat operative të një niveli të ulët (për shembull, operimi i ndërprerësve të nivelit 35 KV ose riparimi i gabimeve në transformatorët 10/0.4 KV) do të kërkojnë sisteme të sofistikuara në fushën e raportimit, duke kërkuar kosto dhe kohë të konsiderueshme për zhvillimin e sistemit (deri në dy vjet).

Duhet të vihet re se KEK-u ka ofruar një numër të madh të dhënash teknike dhe operative për ZRRE-në si pjesë e procesit për Rishikimin e Licencave. Kjo ka qenë një përpjekje e përbashkët e suksesshme në të kaluarën dhe nuk ka pasur asnjë problem sa i përket disponueshmërisë së të dhënave.

## **Informacionet lidhur me Kosovën Veriore**

ZRRE-ja është shumë e vetëdijshme për faktin se KEK-u nuk ka qasje në asnjë prej objekteve në veri të lumit Ibër. Që nga viti 1999, ato objekte kanë qenë nën kontrollin e një operatori ilegal. Prandaj, format e të dhënave që kanë të bëjnë me ndonjë objekt ose konsumator në Veri nuk mund të sigurohen prej KEK-ut. KEK-u ka informacione kontabël të energjisë për të përcaktuar sasinë e energjisë me të cilën furnizohet Veriu në 110 KV në Nënstacionin e Vallaqit; megjithatë asnjë informacion tjetër për ndryshimet në konfigurimin e sistemit dhe listën e aseteve që nga viti 1999 nuk është në dispozicion. Ngjashëm, lista e konsumatorëve nga periudha e para-luftës është natyrisht e vjetër.

## **Rëndësia e Bilancit Energjetik**

Vlerësimi i furnizimit dhe kërkesës për energji (duke iu referuar si Bilanci Energjetik në Kosovë) është një pikë fillestare tipike për parashikime në industrinë e energjisë elektrike. Raportet konsultative nuk e përmendin Bilancin Energjetik. KOSTT-i së fundi ka përgatitur një procedurë të detajuar për parashikimin shumëvjeçar të energjisë. Është e rëndësishme që të gjithë të licencuarit të punojnë me të njëjtin grup të të dhënave, në mënyrë që parashikimet financiare dhe operative të jenë në përputhshmëri.

## **Standardet e Performancës në Mjedisin e Kosovës**

Rregullatorët shpesh përdorin standardet e performancës që të vlerësojnë performancën e të licencuarve. Stimulimet shpesh inkorporohen në procesin tarifor. Në Kosovë, nuk ka stimulime të konsiderueshme për OSSH për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale, meqë ekziston një kufi/limit në përqindjen e lejuar të humbjeve.

Duhet pasur kujdes kur kapaciteti i një objekti të shkurtë me infrastrukturë të dobët dhe me tarifa shumë të ulëta krahasohet me vendet e zhvilluara. Kjo do të merr kohë dhe para për përmirësim, prandaj ndëshkimet mund të mos jenë të përshtatshme në këtë kohë.

KEK-u falënderon ZRRE-në për mundësinë për të ofruar komente në këtë proces tarifor shumëvjeçar shumë të rëndësishëm që është duke u zhvilluar. Përveç pikave të përfshira në këtë letër, komentet janë ofruar në Raportin Konsultativ dhe është paraqitur edhe një tabelë me komente mbi 47 fletëpune të propozuara për mbledhjen e të dhënave.



Kopje për:

Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës

Z. Zenun Pajaziti, Kryesues i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri

Z. Petrit Pepaj, Drejtor për Çështje Tarifore dhe Rregullative, KEK Sh.a.

Z. Fadil Ismaili, Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.a.

Znj. Resmije Ahma, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.a.

Znj. Fllanza Hoxha, Menaxhere e Projektit për Privatizimin e KKDFE-së

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a është kompani e korporatizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës

Numri i Regjistrimit: 70325399

Zyra e regjistruar: Rr. Nënë Tereza Nr. 36, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës